Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

KAÇANIKU

Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

*01Nr. 104/02-16111/19*
***Kaçanik, 31.10.2019***

Në bazë të nenit 12.2. 14.1 lidhur me nenin 17 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 6 pika 1.2 lidhur me nenin 19 pika 3.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 –Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ( Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/03 Prill 2019 ), të nenin 6.2(h) të Statutit të Komunës, duke vepruar sipas Rekomandimit të Komisionit vlerësues me Numër të Protokollit. 01Nr. 104/02-34040/19 (bashkangjitur lëndës) -për përzgjedhjen e ofertës ekonomikisht me të favorshme, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur më 31 Tetor 2019, mori këtë:

**VENDIM**
**PËR DHËNIEN NË SHFYTËZIM AFATGJATË (99 VJET) PRONËN E PALUAJTSHME TË KOMUNËS, PARCELA KADASTRALE P-70917086-01405-0, ZONA KADASTRALE KAÇANIK I VJETËR, KOMPANISË, N.T.SH. "LYPETENI" NË F. NIKAJ**

1. Me këtë vendim, I jepet në shfrytëzim afatgjatë- për, **99 Vjet (Nëntëdhjetenëntë vjet), Kompanisë N.T.SH. "LYPETENI"** Nr. fiskal ARBK 810300608, në f. Nikaj, në emër të, **Fadil S. Guri** nga f. Nikaj, Komuna e Kaçanikut, Prona e Paluajtshme e Komunës, Parcela Kadastrale P-70917086-**01405-0** Zona Kadastrale Kaçanik i Vjetër, në sipërfaqe: **0.86.24 ha** në vendin e quajtur "Çardak" tokë bujqësore kullosë e klasës së 3, P.SH. Kuvendi i Komunës Kaçanik.

2. Prona e paluajtshme komunale e potencuar në këtë vendim, jepet në shfrytëzim afatgjatë për, 99 vjet (Nëntëdhjetenëntë vjet), kompanisë nga pika 1. e këtij vendimi- N.T.SH. "LYPETENI" . Nikaj, me qëllim të rritjes së kapaciteteve; prodhim, montim dhe shërbime me vlerë të investimit, 1.215.000€ (një milion e dyqind e pesëmbëdhjetëmijë euro), krijimin e vendeve të reja të punës prej 64 punëtorëve.

3. E drejta e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme, nuk mund të bartet në shfrytëzim të personave të tretë.

4. Obligohet Kryetari i Komunës që të nënshkruajë Kontratë me kompanitë fituese si në pikën 1. të këtij vendimi- me Kompaninë N.SH.T " LYPETENI" " në të cilën kontratë do të përcaktohen të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese, në pajtim me nenin 19, paragrafit 3.2 të Ligjit Nr. 06/L-092 – Për Dhënien në shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

5. Për Mbikëqyrjen dhe realizimin e kontratës do të kujdeset, Kryetari i Komunës, i cili në pajtim të dispozitave të nenit 22 të Ligjit Nr. 06/L-092 – Për Dhënien në shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, obligohet të paraqet raport 6 mujor Kuvendit të Komunës

REPUBLIKA
KOMUNA E

dhe raport të veçantë për realizimin dhe përmbushjen e qëllimit të dhënies së pronave komunale në shfrytëzim si dhe veprimet tjera( masat e caktuara ndaj shfrytëzuesit- përshirë edhe rekomandimin për shkëputje të kontratës) që duhet të merren në rast të mosrealizimit të planit dinamik dhe kushteve të përcaktuara në kontratë.

6. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona i kthehet komunës. Kryetari i Komunës është i obliguar të njoftoj Kuvendin e Komunës, duke përshkruar gjendjen aktuale të pronës si dhe të jap propozime për destinimin e pronës në të ardhmen, në pajtim të pikës 2 të nenit 23 të Ligjit me numër të theksuar si më lartë.

7. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit.

8. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës të MAPL , si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen zyrtare të komunës.

**Me këtë vendim njoftohen:** MAPL, Kryetari i Komunës - (përmes Zyrës së Kryetarit, njoftohet pala dhe mekanizmat tjerë relevantë), Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAČANIK
REPUBLIKA KOSOVA

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

020-1131/6
27.11.2019

| | | |
|---|---|---|
| Për: | **Besim Ilazi**, Kryetar i Komunës së Kaçanikut<br>**Kemal Mërseli**, Kryesues i kuvendit të Komunës së Kaçanikut | |
| Kopje: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | **Adrijana Hodžić**, Ministre e MAPL-së<br>**Rozafa Ukimeraj**, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së | |
| Nga: | **Besim Myrtezani** U.D. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave | Datë: 15/11/2019 Nr.020-1131 |
| Zyrtaret përgjegjës:<br>1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | **Xhevat Tafa**, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br>**Gëzim Sahiti**, Zyrtar i lartë për monitorim të komunave | |
| Lënda: | Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kaçanikut | |
| Lloji i aktit: | □ Vendim i Kuvendit të Komunës | |

I nderuar Kryetar,
I nderuara Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendimi 01.Nr.104/02-16111/19, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (99 vite) prona e paluajtshme e komunës parcela kadastrale P-70917086-01405-0, zona kadastrale Kaçanik i vjetër, kompanisë, NTSH "Lypoteni" në Nikaj. |
| I miratuar më datë: 31.10.2019 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 07.11.2019 |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural <u>**është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi**</u> dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

YPETENI
NIKAJ-KAQANIK

# Ofertë për konkursin publik të Komunës së Kaçanikut për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës në shfytëzim afatgjatë

03.06.2019 KAÇANIK

01 104/02-16114

*N.SH.T "LYPETENI "*

Data:*03.06.2019*

BIZNES INDIVIDUAL "LYPETENI" KAÇANIK

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E KAçANIKUT • OPŠTINA KACANIK • MUNICIPALITY OF KAÇANIK

http://kk.rks-gov.net/kacanik/

AÇANIKU

# KOMISIONI PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM DHE KËMBIMIT TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

| | |
|---|---|
| DATA/DATUM/DATE | 23.09.2019 01-105/02-[illegible]-34040/19 |
| 01 NR/BR. | Zyrtarisht |

| | |
|---|---|
| PËR/ZA/TO | Kryetar i Komunës z.Besim Ilazi<br>Kryesuesi i Kuvendit z.Kemal Murseli |
| NGA/OD/FROM | Komisioni për vlerësim<br>Kadri Krivenjeva<br>Kaltrina Tafili<br>Zekirja Elezi<br>Besnik Bajra<br>Remzi Shabani |
| LËNDA/PREDMET/SUBJECT | **Rekomandim i Komisionit për përzgjedhjen e ofertës ekonomikishtë më të favorshme** |

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAÇANIKUT OPŠTINA KAČANIK REPUBLIKA KOSOVA

**I nderuar Kryetar**

Duke u bazuar në nenet 1,5,6,8, 17 të Ligjin Nr.06/L-092, për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Komisioni Vlerësues i ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim, në sallën e komiteteve të Kuvendit Komunal, me dt. 28.06.2019 pas përfundimit të konkursit publik,si dhe pas shqyrtimit të raportit të komisionit të ankesave, ka bërë përzgjedhjen e ofertës ekonomikisht më të favorshme, për aprovim në Kuvendin e Komunës

Më poshtë keni të dhënat në formë tabelare:

| **Të dhënat kryesore** | |
|---|---|
| Operatori Ekonomik | **N.T.SH."LYPETENI"** |
| Parcela kadastrale | **70917086-01405-0** |
| Përshkrimi i pronës | **P.SH.K.K.-Kaçanik** |
| Vendi i Pronës | **"Çardak"-Kaçanik i Vjetër- Kaçanik** |
| Sipërfaqja e aprovuar | **0.86.24ha** |
| Kohëzgjatja e aprovuar | **99 vite** |

| | |
|---|---|
| Vlera e investimit | **1.215.000 €** |
| Numri i punëtorëve i propozuar për punësim | **64** |
| Aktiviteti i biznesit | **Prodhim, montim dhe shërbime** |
| | |

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO• REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E KAÇANIKUT • OPŠTINA KACANIK • MUNICIPALITY OF KAÇANIK

# KOMISIONI VLERËSUES PËR DHËNIEN E PRONËS SË PALUJTSHME TË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM

# APLIKACIONI PËR MARRJEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS KOMUNALE

## Formular për Aplikim

Kaçanik, 2019

Parcela kadastrale për të cilën konkuroni të merrni në shfrytëzim të parapara me **Konkursin Publik.**

Parcela kadastrale nr. P-70917086-01407-0 P-70917086-01405-0

**1.Të dhënat themelore të aplikuesit .**

**Emri i aplikuesit për personin fizik Ose personin juridik- emri i biznesit** N.SH.T „LYPETENI"

Adresa J. NIKAJ Komuna KAÇANIK

Shteti KOSOVË Tel/fax 044-120-485

Numri Personal 1 0 0 4 4 5 8 6 2 8

E mail adresa: Lypeteni-nikaj@live.com

**1.a). Statusi juridik.**

1.b) Nr.i regjistrimit të biznesit

1.e) Nr. Fiskal ARBK 8 1 0 3 0 0 6 0 8

1.c) **Aktiviteti i biznesit**

prodhim ☑ montim ☑ shërbime ☑ veprimtari tjera ☐

1.d) Përshkrimi i shkurtër i biznesit (plani i biznesit ).

Prodhim Paleta, Mobileri, dyer, shkallë, Pelet, Briket

Montim Shkallë, Mobilje,

Përpunim Përpunim i drurit dhe Pllakave MDF

Shërbime Pyllëzime dhe Rrallime e Pastrime Pyjesh

Veprimtari tjetër ..........

2.Numri i vendeve të punës:

Egzistuese 30 Propozuara 144

3.Vlera e investimeve: në Euro 4 430 000 Me fjalë(Katër milion e katërqind e tridhjet mijë).

4.Teknologjia:

Teknologjia e re 2.000000 Viti i prodhimit 2018/19

Teknologjia e përdorur 500.000 Viti i prodhimit 2001-2010

5. Hapësira e kërkuar për marrjen në shfrytëzim të pronës: 34 554 m².

Shkurtimishtë arsyetimin për pronën e kërkuar për shfrytëzim
Momentalisht ne operojmë në një hapsirë të ~~pamo~~ pamjaftueshme për nevojat dhe kërkesat tona. Mungesa e hapsirës na pamundëson ne zgjerimin e veprimtarisë tone prodhuese, e domosdoshme për të përmbushur kërkesat e klientëve. Zgjerimi i hapësirës për ne rritë mundësinë për të rritur kapacitetet tona prodhuese dhe shërbyese si dhe rritjen e numrit të punëtorëve.

6. Efektet në ambient:

6.a A e ndotni ambientin me aktvitetin tuaj:

- JO [V] ( arsyetoni me fjalë ) përdoret makineri e teknologjisë së re
- PO [ ] (arsyetoni me fjalë) ...........

6.b Nëse PO ju e ndotni:
* Ajrin [ ] Tokën [ ] Ujin [ ] Bëni zhurma [ ]

6.c Masat mbrojtëse që i ndërmerrni në rast se ndotni ambientin (bëni shkurtimishtë specifikimin e atyre masave
Nuk e ndotim Ambientin, përkundrazi veprimtaria jonë ndikimon në ruajtjen e Ambientit

.....................................................................................................................................................................

.....................................................................................

7. Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Fletë aplikacioni i plotësuar dhe nënshkruar. ✓
- Letërnjoftimi fotokopje. ✓
- Çertifikata e regjistrimit të biznesit (për subjektin juridik). ✓
- Biografia e kompanisë ose e personit fizik që aplikon. ✓
- Referenca për kompaninë ekgzistuese. ✓
- Vërtetim për përmbushjen e obligimeve tatimore ndaj ATK (për bizneset vendore). ✓
- Dëshminë për përmbushjen e obligimeve ndaj Komunës (për bizneset vendore dhe personat fizik). ✓
- Plani i biznesit. ✓
- Projekti ideor. ✓
- Plani dinamik i investimeve. ✓
- Qarkullimi Bankar për 3 vitet e fundit, ✓
- Dëshmi nga Gjykata: ✓

-Për personat juridik - dëshmi nga Gjykata që biznesi nuk ka falimentuar ose insolvent gjatë dy viteve të fundit dhe ndaj të njejtit nuk është inicuar procedura e likuidimit apo falimentimit .
- Për personat fizik dëshmi nga Gjykata që nuk është nën hetime.

8. Të dhënat plotësuese që lidhen me biznesin tuaj ( si motivimi për biznes,eksperienca ) etj.

Ne si biznes në përpunimin e drurit kemi përvojë shumë vjeçare që nga viti 1967. Nga atëherë ne kemi zhvilluar dhe rritur biznesin tonë, dhe synojmë të rritemi dhe zhvillohe-i tutje duke u bazuar në punën tonë dhe kërkesat e klientëve.

Data e aplikimit:
Kaçanik 03. 06 2019.

Nënshkrimi i aplikuesit:
[signature]

N.SH.T "LYPETENI" BIZNES INDIVIDUAL KAÇANIK

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR /MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA/MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70917086-01405-0

| | |
|---|---|
| **Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:** | **941-13036/2019** |
| **Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:** | 30.04.2019 - 15:01 |
| **Komuna / Opština / Municipality:** | Kaçanik / Kaćanik / Kaçanik |
| **Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:** | KAÇANIK I VJETËR / STARI KAČANIK / KAÇANIKU I VJETËR |
| **Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:** | Kaçanik / Kaćanik / Kaçanik |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>($m^2$) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **P-70917086-01405-0** | **PARCELË / PARCELA / PARCEL** | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | Rural | **8624** | 5-2019 | | 28.03.2019 |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendbanimi - adresa<br>Prebivaliste - adresa<br>Resident - address | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address Details | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| ÇARDAK/ÇARDAK/ÇARDAK | | ÇARDAK | | 28.03.2019 |



**Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person**

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Kullosat/Pašnjaci/pasture | Kullosë E Klasës 3/Pasnjak 3 Klase/3rd Class Pasture | **8624** |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / single possessor | **P.SH. KUVENDI I KOMUNËS KAÇANIK** | KCID0902555 | KAÇANIK / KAČANIK / KAÇANIK / | | KAÇANIK | **1/1** | | |

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosova

*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning*

**AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY**

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : KAÇANIK

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Kaçanik i vjetër

06-941-13036/2019

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m2 |
|---|---|---|
| P-70917086-01405-0 | Parcelë / Parcela / Parcel | 8624,0 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:2209

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 30.04.2019

Koha/ Vreme/ Time: 03:04:46

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAÇANIKUT OPŠTINA KAČANIK REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO• REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E KAÇANIKUT • OPŠTINA KACANIK • MUNICIPALITY OF KAÇANIK

KAÇANIKU

Pas përfundimit të vlerësimit të ofertave të konkursit publik të shpallur më datë 15.05.2019 me numër 01-104/02-14561/2019, dhe të hapur më datë 28.06.2019, pas shqyrtimit të raportit të komisionit për ankesa si dhe pas pranimit të Aktvendimit nga Gjykata Themelore Ferizaj- dega në Kaçanik, Komisioni Vlerësues i Ofertave për dhënien e Pronës së Paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim në mbledhjen e mbajtur me datë 23.09.2019 jep këtë:

## NJOFTIM PËR PËRFITUESIN E PRONËS KOMUNALE NË SHFRYTËZIM AFAGJATË

| Nr. | Emri dhe mbiemri i aplikuesit | Emri dhe Numri i Parcelës | Emri i Pronës | Sipërfaqja | Zona Kadastrale |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | N.T.SH."Lypeteni" | "Çardak" P-70917086-01405-0 | Pronë Shoqërore-Kaçanik | 0.86.24 ha | Kaçanik i Vjetër Kaçanik |
| 2. | z.Fatmir Gashi | " Fusha e Madhe" P-70917003-02706-6 | Pronë Shoqërore-Kaçanik | 0.20,01 ha | Begracë-Kaçanik |

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAČANIK

| Data 30.09.19 | Vendi KAÇANIK | |
|---|---|---|
| Nj. org. | Numri | Shtojcë |
| 01 | 104/02-32020 | -/- |

Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës

Kryesues Besnik Bajra

Data: 15.5.19 Vendi: Kaçanik
01 - 104/02-14561/2019

KAÇANIKU

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E KAÇANIKUT • OPŠTINA KACANIK • MUNICIPALITY OF KAÇANIK

Mbështetur në nenet 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 16, të Ligjin Nr.06/L-092, për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, vendimi 01Nr.16-4996/2016, si dhe vendimi për ndryshim plotësimin paraprak të Kuvendit Komunal të Kaçanik për dhënjen e pronës së paluajtëshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë, 01Nr.104-2-9777/2017, Komisioni Vlerësues i ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim i caktuar me vendim të Kuvendit të Komunës së Kaçanik, 01.Nr.104/02-2312/19, të dt. 29.01.2019, në mbledhjen e mbajtur me datë 15.05.2019 shpallë këtë:

# NJOFTIM PËR KONKURS PUBLIK

## KONKURS PUBLIK PËR DHËNIE E PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM AFATGJATË

**Njoftim publik për dhënie e pronave të paluajtshme në pronësi të Komunës, përmban si në vijim:**

**Afati i dhënies në shfrytëzim të këtyre pronave të paluajtshme të Komunës është afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite.**

- Parcela Kadastrale nr. **P-70917086-01407-0**, ne sipërfaqe te përgjithshme **25930 m²** P.SH. KK Kaçanik, me kulturë kullosë e klasës 3, qe gjendet ne "**Çardak**"-Zona Kadastrale **Kaçaniku i Vjetër-Kaçanik.**
- Parcela Kadastrale nr. **P-70917086-01405-0**, ne sipërfaqe te përgjithshme **8624 m²** P.SH. KK Kaçanik, me kulturë kullosë e klasës 3, qe gjendet ne "**Çardak**"-Zona Kadastrale **Kaçaniku i Vjetër-Kaçanik.**
- Parcela Kadastrale nr.**P-70917086-00401-0**, ne sipërfaqe te përgjithshme **34594 m²**, P.SH.KK Kaçanik, me kulture kullosë e klasës 4, qe gjendet ne vendin e quajtur: "**Gllavica**" Zona Kadastrale **Kaçaniku i Vjetër-Kaçanik.**
- Parcela Kadastrale nr. **P-70917026-00143-0**, në sipërfaqe te përgjithshme **49490m²** , P.SH .K.K .Kaçanik me kulture kullose e klasës 4, qe gjendet ne vendin e quajtur" **Fusha e Mulës**" Zona Kadastrale **Doganaj-Kaçanik.**
- Parcela Kadastrale nr.**P-70917003-02706-0**, në sipërfaqe të përgjithshme **39364m²**,P.SH.K.K.Kaçanik me kultur kullose e klasës 3, që gjendet në vendin e quajtur **"Tren Mala Fusha Mole"**Zona Kadastrale **Begracë-Kaçanik.**

**Afati i dhënies në shfrytëzim të këtyre pronave të paluajtshme të Komunës është afatgjatë prej katërdhjetë (40) vite.**

- Parcela Kadastrale nr. P-70917086-01405-0, ne sipërfaqe te përgjithshme **6628 m$^2$** P.SH. KK Kaçanik, me kulturë kullosë e klasës 3, qe gjendet ne "**Çardak**"-Zona Kadastrale **Kaçaniku i Vjetër- Kaçanik**
- Parcela Kadastrale nr.P-70917086-00402-0, ne sipërfaqe te përgjithshme **9548 m$^2$**, P.SH.KK Kaçanik, me kulture kullosë e klasës 4, qe gjendet ne vendin e quajtur: "**Gllavica**" Zona Kadastrale **Kaçaniku i Vjetër-Kaçanik**
- Parcela Kadastrale nr.P-70917086-00403-0, ne sipërfaqe te përgjithshme **3299 m$^2$**, P.SH.KK Kaçanik, me kulture kullosë e klasës 3, qe gjendet ne vendin e quajtur: "**Gllavica – Mahalla e Përzhve**" Zona Kadastrale **Kaçaniku i Vjetër-Kaçanik**
- Parcela Kadastrale nr. P-70917003-01579-0, në sipërfaqe te përgjithshme **6840 m$^2$** , P.SH .K.K .Kaçanik me kulture kullose e klasës 3, qe gjendet ne vendin e quajtur" **Gllavica Fusha e Mole**" Zona Kadastrale **Begracë-Kaçanik.**
- Parcela Kadastrale nr.P-70917003-02647-0, në sipërfaqe të përgjithshme **2764m$^2$**,P.SH.K.K.Kaçanik me kultur kullose e klasës 3,që gjendet në vendin e quajtur **"Tren Mala Fusha Mole"**Zona Kadastrale **Begracë-Kaçanik**
- Parcela Kadastrale nr.P-70917003-01580-0, në sipërfaqe të përgjithshme **23379m$^2$**,P.SH.K.K.Kaçanik me kultur kullose e klasës 3,që gjendet në vendin e quajtur **"Tren Mala Fusha Mole"**Zona Kadastrale **Begracë-Kaçanik**

**Veprimtaria që ushtrohet sipas destinimit të pronës:**

- **Parcelat** të theksuara më lartë janë të destinuara për **Zhvillim Ekonomik** – zona industriale me (PZHK) Vendim të Kuvendit të Komunës.

**Kriteret për vlerësimin e ofertave**

- Vlera e investimit, numri i të punësuarve nga investimi, lloji i investimit, përfitimi i komunës;

**Të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve në konkurs publik;**

- Të drejtë pjesëmarrje dhe konkurrimi, kanë të gjithë personat fizik dhe juridik të Republikës së Kosovës.

- Komisioni vlerësues, pas përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës e procedon në Kuvendin e Komunës për aprovim ofertën e përzgjedhur nga komisioni.Specifikat tjera do të bëhen me marrveshje;.
- Për zbatimin e vendimit të Kuvendit të Komunës, obligohet Kryetari i Komunës të nënshkruan kontratë me fituesin, me anë të së cilës përcaktohen të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.
- Pala e pakënaqur me vlerësimin e komisionit, ka të drejtë të parashtrojë ankesë pranë komisionit për vlerësimin e ankesave në afatë prej shtatë (7 ) ditësh.

**Kushtet apo kufizimet mbi dhënien e të drejtave në shfrytëzim :**

- Prona nuk mund të përdoret për qëllime tjera, vetëm siç është përcaktuar me konkurs publik dhe i njëjti nuk mund të bartet në shfrytëzim te personat e tretë.

**Kohëzgjatja e shpalljes së konkurimit publik dhe data e fundit e dorëzimit të ofertave:**

- Kohëzgjatja e shpalljes së konkurimit publik për dhënien e pronave për shfrytëzim afatgjatë është **pesëmbëdhjetë (15) ditë** nga dita e publikimit në ueb-faqen e Komunës, në vendet publike, elektronike dhe të shkruara.
- Dokumentacioni për ofertim tërhiqet në Qendrën për shërbim ndaj qytetarëve (kati përdhesë nr. 5) nga **data 15.05.2019, deri me date 29.05. 2019** në ora: **16:00 h**.

**Vendi, koha ku do të mbahet konkursi publik:**

- Në sallën e Kuvendit Komunal, me dt. **01.06.2019**, në ora: **14:00**, do të bëhet hapja e ofertave të mbyllura dhe të njëjtat do të bëhen publike gjatë hapjes, duke siguruar qasje të drejtpërdrejtë për pjesëmarrësit në konkurs publik.

**Vërejtje:**

. Të interesuarit mund të informohen (çdo ditë pune ) përmes
-Ueb faqës –http//kk-rks-gov.net/kacanik/
-Te.038-200 46-423
-Email Besnik.Bajra @rks-gov.net

**Kaçanik ; 15.05.2019**

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAÇANIKUT OPŠTINA KAČANIK REPUBLIKA KOSOVA

Komisioni vlerësues i Ofertave